

PROPOZIMI PËR KODIN E QEVERISJES KORPORATIVE PËR NP

Ky Kod i Qeverisjes Korporative përcakton standardet minimale që duhet të zbatohen për secilën Ndërmarrje Publike në Kosovë ('NP'). Secila NP duhet të zbatoj kodet, mbrojtjet dhe mekanizmat, përveç këtyre që përmenden në këtë Kod, me qëllim të qeverisja e përbashkët të jetë në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare.

I Korniza Ligjore dhe Rregullative për NP.

1. Asetet e Ndërmarrjeve Publike në Kosovë (NP) menaxhohen në emër të Kosovës nga një agjencion i ndarë, i pavarur nga qeveria, i cili është përgjegjës për administrimin e tyre si i besuari i pronarëve të ndërmarrjeve. Agjencioni i njohur si Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) është përgjegjës gjithashtu për ruajtjen dhe rritjen e vlerës, mundësisë për sukses dhe qeverisjes së këtyre ndërmarrjeve nën juridiksionin e saj.
2. Forma legale e NP duhet të jetë Shoqëri Aksionare ku e drejta e pronësisë i është dhënë AKM (apo ndonjë subjekti trashëgues të saj).
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e NP përveç funksionit (eve) të tyre kryesore duhet të caktohet me ligj, të jetë e hapur për opinionin dhe duhet të bëhet në mënyrë transparente.
4. NP i nënshtrohen të gjitha ligjeve në fuqi në Kosovë të cilat zbatohen për subjektet afariste, përveç (i) kur ato përjashtohen me ndonjë ligj nga Rregullorja e AKM apo ndonjë Rregullore tjetër e UNMIK-ut në fuqi ose (ii) kur ato i nënshtrohen kërkesave për zbulim dhe atyre rregullative, përveç atyre të cilat vlejné për bizneset private.
5. Struktura e kapitalit e NP mund t'i nënshtrohet përshtatjes së ofruar, nëse ajo përshtatje: (i) kërkohet me ligj ose (ii) është e lidhur në mënyrë të arsyeshme me planet e biznesit të NP. Në asnjë rast nuk mund të ndryshohet struktura kapitale e NP për ndonjë arsye të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë për afarizmin e NP.
6. NP nuk duhet të kenë trajtim të privilegjuar sa i përket qasjes në financa, megjithatë në mënyrë që të sigurohet hyrja e financimit të huaj në Kosovë, mund të bëhen marrëveshje të posaçme për NP të caktuara. Këto marrëveshje mund të bëhen për qarkullimin fillestar të kapitalit dhe nuk përsëriten pasi kz kapital mund të përfitohet në kushte jopriviligjuese.

II Autoritetet Qeverisëse në Kosovë si të Besuar të Pronarëve

1. Autoritetet qeverisëse nuk duhet të jenë të përfshira në menaxhimin ditor të NP dhe do të i lejojnë menaxhmentit të NP të ketë autonominë e plotë vepruese. Bordet e Drejtorëve të NP duhet të trajtohen si subjekte të pavarura dhe duhet të lejohen t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre pa ndërhyrje. Duhet të jetë kërkesë që Bordi i drejtorëve i secilës NP të ketë përqindje minimale të drejtorëve të pavarur, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 33.3% dhe secilit anëtar të bordit i kërkohet të ketë një minimum të kualifikimeve të përvojës që ka të bëjë me afarizmin e NP.
2. Të drejtat e pronësisë së autoriteteve qeverisëse ushtrohen përmes AKM.

3. AKM duhet të jetë përgjegjëse ndaj institucioneve përfaqësuese, përfshirë UNMIK, IPVQ dhe Kuvendin; Ajo gjithashtu duhet t'i jap llogari të gjitha institucioneve përgjegjëse të auditimit.
4. Të drejtat e pronësisë së autoriteteve qeverisëse ushtrohen në bazë të strukturës ligjore të secilës NP.

III Marrëdhëniet me palët e interesit

1. Autoritetet qeverisëse në Kosovë, AKM dhe vetë NP duhet të njohin dhe të respektojnë të drejtat e palëve të interesit në ndërmarrje.
2. NP duhet të raportojnë për marrëdhëniet me palët e interesit
3. Bordet e NP duhet të hartojnë, zbatojnë dhe të njoftojnë për programet e përputhshmërisë për kodin e brendshëm të etikës.

IV Transparenca dhe hapja për opinionin

1. AKM duhet të bëj raportim të qëndrueshëm dhe përmbledhës për NP dhe të botoj raport përmbledhës vjetor për NP (si dhe të bëjë botimin e raporteve individuale për secilën NP).
2. NP duhet të krijojnë procedura efikase të auditimit të brendshëm dhe të themelojnë funksionin e auditimit të brendshëm i cili monitorohet nga bordi dhe i raportohet atij.
3. NP duhet t'i nënshtrohen auditimeve të jashtme vjetore të pavarura. Kjo është përveç ...[kërkesave të autoriteteve qeverisëse për auditimin e institucioneve publike].
4. NP duhet t'i nënshtrohen standardeve të njëjta të cilësisë së lartë të auditimit dhe kontabilitet sikurse kompanitë e përmendura. Derisa të vij koha për regjimin e tregtisë dhe hartimin e listave (regjistrave) në Kosovë, këto standarde duhet të mirren nga praktikata më të mira ndërkombëtare, siç janë Parimet e Pranuara Ndërkombëtarisht të Kontabilitetit, dhe NP nuk duhet t'i nënshtrohen sektorit të posaçëm shtetëror apo regjimeve të kontabiliteteve të llojit të organizatave buxhetore.
5. NP duhet të hapin informatat për publikun në baza vjetore për ... [të gjitha çështjet që janë në Parimet për Qeverisjen e Përbashkëta të OECD dhe...]

V. Përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve të NP

1. Bordet e Drejtorëve të NP janë përgjegjës për kryerjen e punëve në ndërmarrje, por jo për menaxhimin e tyre të përditshëm, detyrë e cila duhet t'i lihet zyrtarëve të NP.
2. Bordi i Drejtorëve të NP duhet të jetë përgjegjës për monitorimin e kryerjes së detyrave nga ana e menaxhmentit dhe të ofroj udhëzime strategjike, për t'u matur kundrejt objektivave të caktuara nga AKM. Ata duhet të jenë në gjendje të emërojnë dhe shkarkojnë Kryeshefin Ekzekutiv.

3. Bordi i Drejtorëve të NP përbëhet në atë mënyrë që ata të mund të bëjë gjykim të drejtë dhe të pavarur. Praktika e mirë tregon se Udhëheqësi duhet të ndahet nga Kryeshefi Ekzekutiv. Duhet të jetë kërkesë që Bordi i drejtorëve i secilës NP të ketë përqindje minimale të drejtorëve të pavarur, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 33.3% dhe secilit anëtar të bordit i kërkohet të ketë një minimum të kualifikimeve të përvojës që ka të bëjë me afarizmin e NP.
4. Kur është e nevojshme, komisione të posaçme duhet të themelohen për të përkrahur bordin e plotë në kryerjen e funksionit të tij, sidomos sa i përket auditimit, menaxhimit të rrezikut dhe kompensimit.
5. Bordet e Drejtorëve të NP duhet të bëjnë vlerësim vjetor për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga ana e tyre.